



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 11961 Prot

Fier, më 24.10.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr. 85, datë 24.10 2025

“Për miratimin e rishikimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale ‘Ujësjiellës–Kanalizime Fier’ sh.a”

Në mbështetje të neneve 3, 9, pika 1.6, shkronja “a”, 18, 54, pika ‘k’, 55 dhe 64 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”; si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Akt–Marrëveshjes nr. 3075/2 prot., datë 17.04.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës–Kanalizime Fier” sh.a.; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 56, datë 29.05.2025, “Për fillimin e procedurave gjyqësore ndaj Shoqërisë Rajonale ‘Ujësjiellës–Kanalizime Fier’ sh.a.”; si dhe bazuar në draft akt–marrëveshjen e Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës Kanalizime Fier” sh.a.,

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë rishikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës–Kanalizime Fier” sh.a., në rolin e Agjentit Tatimor, për shlyerjen me këste të detyrimit financiar dhe vijimin e bashkëpunimit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve familjarë. Draft marrëveshja bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Të shfuqizojë Akt–Marrëveshjen nr. 3075/2 prot., datë 17.04.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale “Ujësjiellës–Kanalizime Fier” sh.a., për shkak të lidhjes së marrëveshjes së re që e zëvendëson atë në tërësi.
3. Të shfuqizojë Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 56, datë 29.05.2025, “Për fillimin e procedurave gjyqësore ndaj Shoqërisë Rajonale ‘Ujësjiellës–Kanalizime Fier’ sh.a.”, pasi palët kanë arritur një marrëveshje për zgjidhje jashtëgjyqësore të detyrimit financiar.
4. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Fier, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit, Drejtoria e të Ardhurave Vendore dhe Drejtoria Juridike, për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes sipas kushteve të dakordësuara ndërmjet palëve.

Drejtoria e Financë Buxhet e Kontabilitet
Pranvera Cina

Drejtoria Juridike
Esmeralda Kapllanaj

Drejtoria e Hartimit të Politikave dhe
Kontrollit për Taksat dhe Tarifat Vendore
Alda Abazi

KRYETARI
Armando Subashi



Zg. R. Pajfti
Zg. Evna
hij. hoxhlleni



BASHKIA FIER

Nr. 7904 Prot.
D. 02/07/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME FIER SH.A

Nr. 1097 Prot

Fier, më 30/06/2025

Lënda : Kerkese per bashkepunim

Drejtuar : Bashkise Fier ✓

Per dijeni : Kryetarit te Asamblese se Pergjitheshme
Z. Flauers Shoshi

Me shkresën nr.7276 prot., datë 19.06.2025 me lëndë “ Dergim fature per arketim ” nga Bashkia Fier në zbatim të Akt Marrëveshjes nr.1757 prot., datë 17.04.2023 lidhur midis Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, neni 5 dhe pika 4 e 6 e aktmarrëveshjes, është dërguar për likujdim arkëtimi i të ardhurave nga vjelja e taksave dhe tarifave vendore familjare,. Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime sha Fier ka ndaj Bashkise Fier sipas Akt Rakordimit deri ne datën 31.12.2024 vleren 254,265,679 leke ,detyrim ky i mbartur nga viti 2021 deri ne daten 31.12.2024.

Në vijmësi, Bashkia Fier ne takim me perfaqesuesit midis palëve, ka kerkuar arkëtimin e këtij detyrimi deri ne daten 16.04.2026 ,date kur mbaron afati ligjor i AKM se sipercituar.

Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, ndodhet ne kushtet e pamundesise financiare per te pranuar kete kerkese te Bashikes Fier.

Në këto kushte, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a, duke u mbështetur në cilesine qe ka Bashkia Fier si Aksioner dhe gjendjen financiare ne të cilen shoqëria ndodhet , ka hartuar një Draft Akt Marrëveshje, ku përcaktohet vlera e detyrimit te prapambetur që mund të likujdojmë cdo muaj sebashku me faturen kohrente..

Per vitin 2025 jemi duke e likujduar detyrimin sipas faturave mujore.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, shqyrtimin e Draf Akt Marrëveshjes së propozuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a., dhe marrjen e një vendimi nga ana juaj.

Bashkelidhur gjeni Akt Marreveshjen qe eshte ne zbatim si dhe draf Akt Marreveshjen e propozuar nga ana jone .

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

ADMINISTRATOR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

DREJTORIA E FINANCË BUXHET DHE KONTABILITET

Nr. 11961/Prot

Fier, më 24.10.2025

RELACION

Lënda: "Për miratimin e rishikimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale 'Ujësjiellës-Kanalizime Fier' sh.a"

-Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Fier

Në mbështetje të neneve 3, 9, pika 1.6, shkronja "a", 18, 54, pika 'k', 55 dhe 64 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore"; si dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Akt-Marrëveshjes nr. 3075/2 prot., datë 17.04.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale "Ujësjiellës-Kanalizime Fier" sh.a.; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 56, datë 29.05.2025, "Për fillimin e procedurave gjyqësore ndaj Shoqërisë Rajonale 'Ujësjiellës-Kanalizime Fier' sh.a."; si dhe bazuar në draft akt-marrëveshjen e Shoqërisë Rajonale "Ujësjiellës Kanalizime Fier" sh.a.,

Bashkia Fier, bazuar në nenin 5 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , me "Agjent tatimor" (Shoqërinë Rajonale "Ujësjiellës-Kanalizime Fier" sh.a., përkufizohet personi juridik që mbledh dhe transferon në Buxhetin e Shtetit tatimet dhe taksat), ka lidhur Akt-Marrëveshjes nr. 3075/2 prot., datë 17.04.2023 për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve familjarë.

Qëllimi i kësaj akt-marrëveshje ka qënë realizimi i vjeljes së taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve "familjarë", nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier për llogari të Bashkisë Fier,në rolin e agjentit tatimor .

Gjatë procesit të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Fier dhe Ujësjiellësit, është konstatuar ekzistenca e një vlere të arkëtuar dhe të pakaluar ne llogari te Bashkisë Fier prej **258,694,172** (dyqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë

Në akt-marrëveshjen në fuqi ndërmjet palëve, është përcaktuar se:

- Ujësjiellësi ka detyrimin që në fund të çdo muaji të kryejë rakordimin financiar me Drejtorinë e Financave pranë Bashkisë Fier;
- Brenda datës 5 të çdo muaji, duhet të derdhë në llogarinë e të ardhurave të Bashkisë Fier shumën e arkëtimeve të realizuara, duke zbritur përqindjen prej 1% deri ne Prill te vitit 2022 dhe 2% të agjentit tatimor, sipas nenit 5 të marrëveshjes;
- Në rast mospagese brenda afatit, agjenti tatimor detyrohet të paguajë kamatëvonesa, të llogaritura sipas interesit zyrtar të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

Pas akt rakordimeve të kryera, rezulton se Ujësjetlësi nuk ka mundur të shlyejë në kohë detyrimet ndaj Bashkisë Fier, për shkak të pamundësive ekonomike dhe vështirësive në arkëtimin e të ardhurave.

Në këtë kuadër, Ujësjetlësi ka paraqitur kërkesë për pagesën me këste të detyrimit të principalit, duke kërkuar gjithashtu që të mos përfshihen kamatëvonesat, pasi aplikimi i tyre do të rëndonte më tej gjendjen financiare të ndërmarrjes por edhe mos te mbaje përqindjen e tij si Agjent Tatimor

Propozimi për marrëveshje të re nga UKRF

Duke marrë në konsideratë vlerën e detyrimit prej **258,694,172** (dyqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë dhe pamundësinë financiare aktuale të Ujësjetlësit gjithashtu faktin që Bashkia Fier është aksionere prej 33.9% në këtë ndërmarrje dhe ka interes për stabilitetin e saj ekonomik si dhe nevojën për të garantuar arkëtimin e plotë të principalit pa krijuar vështirësi të reja financiare për shoqërinë, propozohet nga UKR Fier që:

1. Shuma e detyrimit të principalit të shlyhet me 60 këste mujore;
2. Të mos aplikohen kamatëvonesa për periudhën e shlyerjes;
3. Agjenti tatimor të mos mbajë përqindjen takuese prej 1% deri në muajin Prill të viti 2022 dhe 2%, nga Prill 2022 e në vazhdim duke e derdhur të gjithë shumën e arkëtimeve në llogarinë e Bashkisë Fier;
4. Palët të nënshkruajnë një marrëveshje të re që rregullon këto kushte dhe përcakton afatet e qarta të shlyerjes.

Pra

Duke qenë se qëllimi i Bashkisë Fier është garantimi i arkëtimin të detyrimeve pa cënuar veprimtarinë ekonomike të Ujësjetlësit, kjo zgjidhje shihet si veprim bashkëpunues dhe i dobishëm për të dyja palët.

Në këtë kuadër, i propozohet Këshillit Bashkiak Fier:

- Miratimi i marrëveshjes së re për pagesën me 60 këste të detyrimit të Ujësjetlësit;
- Heqja e aplikimit të kamatëvonesave;
- Mosperfitimi e përqindjes 1 dhe 2% nga agjenti tatimor deri në shlyerjen e plotë të principalit;
- Shfuqizimin e Akt-Marrëveshjes nr. 3075/2 prot., datë 17.04.2023, të lidhur ndërmjet Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Rajonale "Ujësjetlës-Kanalizime Fier" sh.a.;
- Shfuqizimin e Vendimi nr. 56/2025 29.05.2025, "Për fillimin e procedurave gjyqësore ndaj ShoqërisëRajonale 'Ujësjetlës-Kanalizime Fier' sh.a.";

Ky veprim do të sigurojë një zbatim korrekt dhe të qëndrueshëm të marrëveshjes, duke mundësuar balancim të interesave të përbashkëta midis Bashkisë Fier dhe Ujësjetlësit.

Vendimi nr. 56/2025 u mor për të autorizuar nisjen e procedurave ligjore ndaj Shoqërisë Rajonale 'Ujësjetlës-Kanalizime Fier' sh.a., për shkak të detyrimeve të papaguara ndaj Bashkisë Fier. Pas negociatave ndërmjet palëve, u arrit marrëveshje që përcakton mënyrën e shlyerjes së detyrimit financiar prej **258,694,172** (dyqind e pesëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë .

Në interes të shmangies së procedurave gjyqësore dhe sigurimit të arkëtimit të detyrimeve, palët kanë rënë dakord për një marrëveshje të re që parashikon shlyerje me këste mujore për një periudhë 5-vjeçare, vijim të bashkëpunimit për mbledhjen e taksave vendore

Në këto kushte, Akt-Marrëveshja nr. 3075/2prot., datë 17.04.2023, konsiderohet e shfuqizuar dhe zëvendësohet plotësisht nga marrëveshja e re.


Propozimi për miratimin e marrëveshjes së re dhe shfuqizimin e akt-marrëveshjeve dhe vendimeve të mëparshme është në përputhje me interesin publik dhe legjislacionin në fuqi.

Ju faleminderit!

Drejtoria e Financë Buxhet e Kontabilitet
Pranvera Çina

Drejtoria e hartimit të politikave dhe
kontrollit për taksat dhe tarifatat vendore
Alda Abazi

KRYETARI
Armando Subashi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

SHOQËRIA RAJONALE

“UJËSJELLËS KANALIZIME FIER” SH.A.

Nr. _____ Prot.
Fier, më ____ / ____ /2025

Nr. _____ Prot.
Fier, më ____ / ____ / 2025

AKT-MARRËVESHJE

E lidhur sot, më datë ____ / ____ /2025, në Fier, ndërmjet :

Bashkisë Fier, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, **Z. Armando Subashi**, dhe
Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a., në rolin e Agjentit Tatimor, përfaqësuar
nga **Z.Klodjan Mema**, Administrator.

Palët, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, bien dakord si më poshtë:

NENI 1 – OBJEKTI I MARRËVESHJES

- Objekti i kësaj akt-marrëveshjeje është:

Përcaktimi i mënyrës së shlyerjes së shumës së arkëtuar nga taksat dhe tarifave e faturuara dhe ta pa kaluara nga Agjenti Tatimor ndaj Bashkisë Fier, **në shumën 258,694,172 (dyqind e pesëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.**

- Vazhdimi i bashkëpunimit për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë e abonentëve “familjarë”, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 2 – BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar;
- Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimin e Këshillit të Bashkisë Fier në fuqi për strukturën dhe nivelin e taksave vendore.

- Ka të drejtë të kërkojë informacion periodik mbi arkëtimet dhe derdhjet mujore nga Agjenti Tatimor si dhe brenda datës 20 të çdo muaji të bëjnë akt-rakordin përkatës midis palëve me shkrim.
- Ka të drejtë të kërkojë zbatimin e menjëhershëm të marrëveshjes dhe pagesën e detyrimeve në rast vonese apo mosderdhjeje.

Agjenti Tatimor:

- Ka detyrimin që të bëjë përditësimin e të dhënave në data bazë sipas ndryshimeve të dërguara në formë shkresore nga Bashkia Fier;
- Ka detyrimin që të shënojë si zë me vete, në faturën mujore të ujit të pijshëm, detyrimin e qytetarëve ndaj Bashkisë Fier (i ndarë në këste mujore të barabarta), pa e llogaritur me TVSH;
- Ka detyrimin të derdhë në kohë këstet mujore të detyrimit të prapambetur , sipas nenit 4, pika 1.a dhe pika 1.b të kësaj akt- marrëveshjeje.
- Ka detyrimin të vijojë mbledhjen dhe derdhjen mujore të taksave vendore në llogaritë e Bashkisë Fier duke zbritur % e agjentit tatimor sipas nenit 4 pika 2 të kësaj akt- marrëveshjeje.
- Ka detyrimin të mbajë dokumentacion të plotë financiar dhe të raportojë brenda datës 20 të çdo muaji për muajin paraardhës si dhe të bëjnë akt-rakordin përkatës midis palëve me shkrim.

NENI 8 – KONTAKTI

Për çdo çështje që lidhet me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, komunikimi bëhet me shkrim ndërmjet:

- Drejtorisë së Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit , Drejtorisë së të Ardhurave Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Fier, dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a., në rolin e Agjentit Tatimor.

NENI 9 – NDRYSHIME NË MARRËVESHJE

Çdo ndryshim apo shtesë në këtë akt-marrëveshje mund të bëhet vetëm me pëlqimin e të dy palëve dhe hyn në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit përkatës.

NENI 10 – DISPOZITA TË FUNDIT

1. Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.
2. Në rast se nuk arrihet mirëkuptim, palët i drejtohen Gjykatës Administrative.
3. Kjo akt-marrëveshje hyn në fuqi pas ratifikimit nga organet përkatëse dhe hartohet në katër (4) kopje, nga dy (2) për secilën palë.

BASHKIA FIER

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS

KANALIZIME FIER SH.A

KRYETARI

ADMINISTRATORI
